

| Emri i Lëndës : Komunikim Vizual |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                        |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                     |                     |                     |                |         |      |
|----------------------------------|--------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|---------------------|---------------------|----------------|---------|------|
| Kodi                             | Tipi                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                   | Semestri                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                            | Leksione (orë/javë) | Seminare (orë/javë) | Lab (orë/javë) | Kredite | ECTS |
| IMC 305                          | A                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                      | Vjeshtë                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                             | 3.00                | 0.00                | 0.00           | 3.00    | 5.00 |
|                                  |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                        |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                     |                     |                     |                |         |      |
| Lektori                          |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                        | Nevila Samarxhi, Msc                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                |                     |                     |                |         |      |
| Asistenti                        |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                        |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                     |                     |                     |                |         |      |
| Gjuha e kursit                   |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                        | Shqip                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                               |                     |                     |                |         |      |
| Niveli i lëndës                  |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                        | Program Profesional 2-Vjeçar                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                        |                     |                     |                |         |      |
| Përshkrimi                       |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                        | Kjo lëndë ndihmon studentët të kuptojnë çështjet e perceptimit pamor dhe sesi komunikohet saktë përmes elementëve pamorë, duke u dhënë dije teorike dhe praktike për t'i ndihmuar të kuptojnë dhe të zbatojnë në mënyrë të përgjegjshme e profesionale ato që kanë përfutur në dijet praktike. Kjo lëndë ndihmon edhe studentët e marrëdhënieve publike dhe të komunikimit të marketingut të vlerësojnë dhe t'i përdorin dijet për të përcjellë sa më mirë informacionin në të gjitha fushat e komunikimit. Lënda e Komunikimit Vizual eksploron fushat kryesore teorike në komunikimin vizual dhe paraqet metodat e hulumtimit të përdorura në mënyrat se si njerëzit e shohin dhe se si ndodh procesi i këti komunikimi vizual. Lënda do të përfshijë 12 teoritë kryesore në komunikimin vizual: estetika, perceptimi, përfaqësimi, retorika etj. Njohja me konceptet bazë teorike shtrun rrugën për kuptimin dhe përvetësimin e lëndëve të tjera sipas janë ato të “Dizajnit Grafik”, “Multimedias” apo “Dizajnit të Reklamave”. |                     |                     |                |         |      |
| Objektivat                       |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                        | Kjo lëndë është dizajnuar për të njohur më mirë fushën dhe mjetet e elementët e komunikimit visual. Kjo lëndë do të bëjë që: -Studentët do të kuptojnë vlerën që komunikimi vizual ka në ndërtimin e një mesazhi. -Studentët do të pajisen me njohuri mbi evoluimin e mediave dhe se si ata mund të jenë konsumatorë dhe prodhues të informacionit, reklamës, marrëdhënieve me publikun dhe argëtimin. - Studentët do të mësojnë mënyrat mbi identifikimin dhe përdorimin e burimeve efektive në arritjen e qëllimeve nëpërmjet komunikimit vizual. -Studentët do të zhvillojnë vlerat e esetikës, qëndrimet profesionale dhe aftësitë personale të nevojshme për përgatitjen si specialistë të multimedias dhe dizajnit grafik - Studentët do të kuptojnë vlerën që komunikimi vizual ka në ndërtimin e një mesazhi.                                                                                                                                                                                                               |                     |                     |                |         |      |
| Konceptet Kryesore               |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                        | 1. Komunikim Vizual 2. Teori të Komunikimit Vizual 3. Elementët e Komunikimit Vizual 4. Zbatimi i Parimeve Estetike. 5. Leximi i masazheve, vizuale grafike.                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                        |                     |                     |                |         |      |
| Programi i Lëndës                |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                        |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                     |                     |                     |                |         |      |
| Java                             | Tema                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                   |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                     |                     |                     |                |         |      |
| 1                                | Prezantimi i lëndës, Librat për t'u lexuar, hyrje në lëndë, Cilat janë llojet e Komunikimit Vizual, Tipografi, komunimimi ndermjet gërmave. Grafika me larmi te ndryshme. Paraqitjet e ndryshme foto me nderthurje grafika Komunimkim me foto në lëvizje, jo stabël. Secili prej këtyre llojeve luan një rol kritik në përcjelljen e informacionit dhe bërjen e një dizajni tërheqës vizualisht. <a href="https://www.youtube.com/watch?v=wKjI7tZ9Hj0">https://www.youtube.com/watch?v=wKjI7tZ9Hj0</a> |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                     |                     |                     |                |         |      |
| 2                                | Teoria e Perceptimit - Një perspektivë neurologjike mbi komunikimin vizual. - Revolucioni teknologjik. - Mekanika e Vizionit. - Sistemet Emocionale - Super Pasqyra dhe Përthithje Kulturore. Perceptimi, një proces nëpërmjet të cilit individët organizojnë dhe interpretojnë përshtypjet e ndjenjave të tyre për t'i dhënë kuptim mjedisit ku jetojnë. Diskutim, tema aktuale. Faqe 45/ Book "HANDBOOK OF VISUAL COMMUNICATION THEORY, METHODS, AND MEDIA"                                          |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                     |                     |                     |                |         |      |

|           |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                   |
|-----------|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| <b>3</b>  | Njohja Vizuale - Historia e "të parit" - Shpejtësia e përpunimit, emocioni, ndërgjegjja - Pamjet vizuale dhe audio - Njohja vizuale në një ekosistem mediatik - Imazhet si përfaqësime të botës fizike - Njohja dhe Emocioni. Proceset njohëse formësojnë mënyrën se si ne i perceptojmë, interpretojmë dhe kuptojmë shenjat emocionale, ndërsa emocionet ndikojnë në mënyrën se si ne shprehemi dhe si interpretojmë shenjat emocionale nga të tjerët. Diskutim, rast i huaj dhe shqiptar. *Detyrë foto rastësore në perspektiva të ndryshme për komunikimin vizual! - Imazhet si përfaqësime të botës fizike - Njohja dhe Emocioni Faqe 193/ Book "HANDBOOK OF VISUAL COMMUNICATION THEORY, METHODS, AND MEDIA" |
| <b>4</b>  | Ekulibri Vizual-Verbal - Njohja vizuale dhe përpunimi i informacionit - Roli i përmbajtjes vizuale-verbale në përpunimin e informacionit - Njohja vizuale dhe reklamimi - Dizajni i mesazheve të njohjes vizuale. Dizajnerët ndikojnë në perceptimet e përdoruesve dhe i drejtojnë ata drejt sjelljeve të dëshiruara duke strukturuar elemente vizuale si simbolet e menysë, fontet dhe ngjyrat. Diskutim, komunikimi vizual në botën e sotme nuk është thjesht një ide e mirë. Është jetike. Faqe 196/ Book "HANDBOOK OF VISUAL COMMUNICATION THEORY, METHODS, AND MEDIA"                                                                                                                                        |
| <b>5</b>  | Zbatimi i Parimeve Estetike - Tregimi përmes Fotoraportimit - Fotogazetaria: Estetika, Historia dhe Teknika. - Parimet estetike - Rregulli i të tretave - Mesatarja e Artë ose Raporti i Artë - Hapësira Pozitive - Negative. - Sekretet e padukshmërisë. Edhe pse teoria dhe metodologjia mund të jenë më pak të dukshme dhe më pak të shprehura hapur sesa në kërkimin tradicional, dhe megjithëse estetika mund të duket po aq e rëndësishme sa faktet në prezantimet mediatike, ato shoqëruese binjake të ideimit dhe zgjidhjes së problemeve janë të ngulitura në aplikimet në media.                                                                                                                        |
| <b>6</b>  | Estetika në Produktet Mediatike - Kodimi dhe dekodimi i meta - mesazheve - Çfarë është Estetika e Aplikuar e Medias? - Elementet Themelore - Meta-Mesazhet. - Estetika e medias së aplikuar, teoria dhe metodologjia janë më pak të dukshme dhe më pragmatike sesa në kërkimin tradicional të komunikimit vizual. - Estetistët janë përgjithësisht për konsum masiv. Prodhimet e estetikës së aplikuar mediatike nuk janë më pak të vlefshme si shprehje e njohurive. - Diskutim për platformat e komunikimit me mesazhe. - Dorëzim i detyrës!                                                                                                                                                                    |
| <b>7</b>  | Teoria e Medias Digjitale - Nga komunikimi një-drejtimësh në atë shumë-drejtimësh. - Teksti i fokusuar në platformat vizuale - Teoria e Kultivimit. - Teoria e të mësuarit social. - Korniza e Affordances - Mundësitë e Identitetit - Aftësitë njohëse!                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                          |
| <b>8</b>  | Provimi gjysmefinal                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                               |
| <b>9</b>  | Teoria e Intertekstualitetit Vizual - Eksplorimi i komunikimit politik dhe vizual - Intertekstualiteti përmes luftës së Memeve. - Evolucionit i Intertekstualitetit - Memet politike. Intertekstualiteti analizon nëse është e mundshme të flitet për tekstet origjinale dhe autorët origjinalë. - Theksi vihet mbi kompetencën e lexuesit për ta deshifruar lidhshmërinë ndërmjet teksteve. - Format e intertekstualitetit janë: citimi, parafrazimi, aluzioni, parodia, kolazhi, montimi, reminiscenca.                                                                                                                                                                                                         |
| <b>10</b> | Zhvillimi i Tregimit Vizual - Tregimi vizual i ngjarjeve. - Evolucionit i tregimit pamor. Tregimi është një nga format më të vjetra dhe më të rëndësishme të artit të njohura për njerëzimin. - Si shoqëritë janë formuar, komunikuar dhe janë bërë të pavdekshme përmes kësaj forme arti. - Sistemet e vlerave, mënyrat e jetesës dhe kulturat janë ruajtur ose kanë ndryshuar me kalimin e kohës për shkak të historive të veçanta që u shfaqën në vendbanime të ndryshme njerëzore.                                                                                                                                                                                                                            |
| <b>11</b> | Grafikat informuese. - Infografika është një paraqitje vizuale e informacionit duke përdorur grafikët, grafikët, hartat, tabelat dhe të tjera elementet e projektimit për të komunikuar të dhëna komplekse në mënyrë të qartë dhe efektive. - Infografika kombinon tekstin dhe informacionin grafik për të krijuar një imazh vizual dhe të lehtë për t'u kuptuar të të dhënave.                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                   |
| <b>12</b> | Fotot, ilustrimet trend i fundit! - Çfarë është Dizajni i Ilustrimit? - Dizajni i ilustrimit kombinon dizajnin grafik dhe ilustrimin klasik. - Dizajni grafik i jep përparësi komunikimit dhe ilustrimi bie brenda artit të bukur. - Kështu, dizajni i ilustrimit bëhet më i miri i të dy botëve. Dizajni i ilustrimit do të zbatojë bazat e formës, ngjyrës, formave dhe paraqitjeve.                                                                                                                                                                                                                                                                                                                            |
| <b>13</b> | Filmat, zhanre dhe stile të ndryshme filmash kanë strategji të ndryshme komunikimi vizual, në varësi të qëllimit dhe tonit të filmit. - Komunikimi vizual i ndihmon kineastët të krijojnë një estetikë të qëndrueshme dhe koherente që i përshtatet zhanrit dhe stilit të tyre.                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                   |
| <b>14</b> | Si t'i lexojmë fjalët? Si t'i kuptojmë ato? - Si t'i lexojmë imazhet grafike? - Si të tregojmë histori me elemente multimediale. histori multimediale është përmbajtje narrative që përdor video, imazhe ose audio (ose një kombinim të të treve) për të treguar një histori. - Historitë multimediale mund të përfshijnë vizualizime të të dhënave, infografikë, shfaqje rrëshqitëse, postime në media sociale, harta ndërvepruese, animacione dhe shumë lloje të tjera elementësh vizualë dhe audio.                                                                                                                                                                                                            |

|                                            |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                              |
|--------------------------------------------|----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| <b>15</b>                                  | Përsëritje, çfarë kemi mësuar, çfarë kemi arritur, ku është dallimi me orën e parë të lëndës.                                                                                                                                                                                                                                                                                                |
| <b>16</b>                                  | Provim Final                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                 |
| <b>Parakushtet</b>                         | Studenti duhet të frekuentojë lëndën në masën minimale prej 75%.                                                                                                                                                                                                                                                                                                                             |
| <b>Literatura</b>                          | <ul style="list-style-type: none"> <li>• Leksione të përgatitura nga pedagogu</li> <li>• "Handbook Of Visual Communication Theory, Methods, And Media (2nd ed.)" By Sheree Josephson, James D. Kelly and Ken Smith (2015). New York</li> <li>• "The Power of Visual Storytelling - How to Use Visuals, Videos, and Social Media". by Ekaterina Walter and Jessica Gioglio. (2014)</li> </ul> |
| <b>Referenca të tjera</b>                  | <ul style="list-style-type: none"> <li>• Visual communication : images with messages: Paul Martin Lester, 2020</li> <li>• "Introduction to communication studies (2nd ed.)" by Fiske, J. (1996). London, United Kingdom: Routledge.</li> <li>• "Design for Visual Communication" by Klimis Mastoridis, Niki Sioki and Mary C. Dyson, 2019</li> </ul>                                         |
| <b>Rezultatet e Lëndës dhe Kompetencat</b> |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                              |
| <b>1</b>                                   | Të identifikojë elementët bazë të komunikimit vizual (ngjyra, forma, linja, tekstura).                                                                                                                                                                                                                                                                                                       |
| <b>2</b>                                   | Të shpjegojë se si përbërësit e dizajnit ndikojnë në perceptimin vizual.                                                                                                                                                                                                                                                                                                                     |
| <b>3</b>                                   | Të analizojë mesazhin, audiencën për të përshtatur komunikimin vizual sipas grupeve të ndryshme demografike.                                                                                                                                                                                                                                                                                 |
| <b>4</b>                                   | Të dijë të zbatojë parimet e materialeve vizuale.                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                            |
| <b>5</b>                                   | Të dijë të implementojë teori të ngjyrës dhe kompozimit në dizajne reale.                                                                                                                                                                                                                                                                                                                    |
| <b>6</b>                                   | Të krahasojë vizualet, alternativa të ndryshme të dizajnit dhe sugjerojë përmirësime e ndryshme për ndryshime në mesazh dhe stil.                                                                                                                                                                                                                                                            |
| <b>7</b>                                   | Të dijë të vlerësojë efektivitetin e një projekti të komunikimit vizual.                                                                                                                                                                                                                                                                                                                     |
| <b>8</b>                                   | Të japë feedback kritik për punën e tij dhe të tjerëve.                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                      |
| <b>9</b>                                   | Të zhvillojë projekte të reja vizuale që kombinojnë kreativitetin shtëpi Komunikimit Vizual..                                                                                                                                                                                                                                                                                                |
| <b>10</b>                                  | Të eksperimentojë me forma të ndryshme komunikimi vizual për të inovuar në fushën e marketingut dhe artit.                                                                                                                                                                                                                                                                                   |

| Mënyra e Vlerësimit të Lëndës                                                            |       |                   |                       |
|------------------------------------------------------------------------------------------|-------|-------------------|-----------------------|
| Notat e Ndërmjetme                                                                       | Sasia | Përqindja         |                       |
| Gjysmë finale                                                                            | 1     | 30                |                       |
| Kuize                                                                                    | 0     | 0                 |                       |
| Projekte                                                                                 | 1     | 10                |                       |
| Projekte semestrale                                                                      | 0     | 0                 |                       |
| Punë laborator                                                                           | 0     | 0                 |                       |
| Pjesëmarrja në mësim                                                                     | 1     | 10                |                       |
| Kontributi i notave të ndërmjetme mbi vlerësimin final                                   |       |                   | 50                    |
| Kontributi i provimit final mbi vlerësimin final                                         |       |                   | 50                    |
| Total                                                                                    |       |                   | 100                   |
| Ngarkesa ECTS (Në Bazë të Ngarkesës së Studentit)                                        |       |                   |                       |
| Aktivitetet                                                                              | Sasia | Kohëzgjatja (orë) | Ngarkesa Totale (orë) |
| Kohëzgjatja e kursit (Duke përfshirë edhe javën e provimeve : 16x Orët totale të kursit) | 16    | 3                 | 48                    |
| Orët e studimit jashtë klase (Parapërgatitje, Praktika etj)                              | 14    | 5                 | 70                    |
| Detyra                                                                                   | 1     | 3                 | 3                     |
| Gjysmë finale                                                                            | 1     | 1                 | 1                     |
| Provimi final                                                                            | 1     | 2                 | 2                     |
| Të tjera                                                                                 | 0     | 0                 | 0                     |
| Ngarkesa totale e orëve                                                                  |       |                   | 124                   |
| Ngarkesa totale e orëve / 25 (orë)                                                       |       |                   | 4.96                  |
| ECTS                                                                                     |       |                   | 5.00                  |